

**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Legjislatura III**

Mbledhja e Kryesisë së Kuvendit  
P.001/08  
Prishtinë, më 15 janar 2008, në orën 12:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, të mbajtur më 15  
janar 2008**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit dhe  
anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim  
Gashi dhe Nexhat Daci.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi  
dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Basri Musmurati;

Nga Projekti për Mbështetje të Mëtejme Kuvendit: Hugues Courtivron  
dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

**Kryetari** e hapi mbledhjen dhe propozoi që pikës së tretë të rendit të ditës t'i shtohen edhe disa nënpika.  
Kryesia miratoi propozimin e kryetarit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

## **R E N D I T E**

1. Fjalë rasti e Kryetarit të Kuvendit,
2. Shqyrtimi i propozimit për numrin dhe përbërjen e komisioneve parlamentare, dhe
3. Të ndryshme.

### **1. Fjalë rasti e Kryetarit të Kuvendit**

**Kryetari Jakup Krasniqi**, fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kryesisë të legjislaturës së tretë dhe iu uroi zgjedhjet për Parlamentin e Kosovës. Ai i ftoi anëtarët e Kryesisë për bashkëpunim me qëllim të vazhdimit të një praktike të mirëfilltë dhe krijimin e praktikave të reja për funksionalizimin më të mirë të punës së Kryesisë dhe për ta ndihmuar zhvillimin e demokracisë dhe të proceseve demokratike në Kosovë.

**Kryetari**, gjithashtu u bëri thirrje anëtarëve të Kryesisë për angazhim serioz duke marrë parasysh rolin e Kuvendit të Kosovës në procesin në të cilin po kalon Kosova dhe propozoi që, përveç mbledhjeve të Kryesisë, të mbahen edhe takime të tjera joformale me qëllim të funksionalizimit me të mirë të Kryesisë dhe të Kuvendit në përgjithësi.

Ai u propozoi anëtarëve të Kryesisë të angazhohen për të ndihmuar komunitetin serb dhe komunitetet joserbe për të pasur përfaqësuesit e tyre në Kryesinë e Kuvendit, sa më parë, duke theksuar se procedimi i obligimeve tona do ta ketë një peshë më të mirë dhe në një mënyrë do të kenë pjesën dhe angazhimin e vet edhe dy përfaqësuesit e minoriteteve në Kosovë.

Duke ju dëshiruar sukses anëtarëve të Kryesisë, ai kërkoi bashkëpunim dhe punë kolektive, në përputhje me interesat e proceseve politike që po i kalon Kosova.

**Kryetari** kërkoi nga anëtarët e Kryesisë që të procedohet sipas propozimit të rendit të ditës. Kryesia miratoi propozimin e kryetarit.

### **2. Shqyrtimi i propozimit për numrin dhe përbërjen e komisioneve parlamentare**

## **a) Propozimi për numrin e komisioneve parlamentare**

**Kryetari** njoftoi anëtarët e Kryesisë me mënyrën e rregullimit të numrit të komisioneve duke theksuar se në bazë të Rregullës 41.1 të Rregullores së Punës, përveç Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe të Komisionit për Buxhet e Financa, që janë të paraparë me Kornizë Kushtetuese, për komisionet e tjera funksionale dhe për numrin e tyre vendos Kuvendi me propozim të Kryesisë.

Mbi këtë bazë kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë se është bërë propozimi për numrin , emërtimin dhe përbërjen e komisioneve parlamentare, i cili u është shpërndarë të gjithë anëtareve.

Lidhur me këtë **kryetari** hapi debatin, duke kërkuar deklarinimin e anëtarëve të Kryesisë.

Në debat morën pjesë të gjithë anëtarët e Kryesisë, të cilët në diskutimet e tyre mbështetën në tërësi propozimin e prezantuar.

**Kryesia**, lidhur me numrin dhe emërtimin e komisioneve parlamentare vendosi që Kuvendit t'i propozojë krijimin e komisioneve parlamentare, si në vijim :

1. Komisioni për Buxhet Dhe Financa (12 anëtarë sipas K.K),
2. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim (14 anëtarë sipas K.K ),
3. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ,11 anëtarë,
4. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, për Personat e Pagjetur dhe për Peticione ,11 anëtarë,
5. Komisioni për Bashkëpunim me Jashtë ,11 anëtarë,
6. Komisioni për Integritet Evropian ,11 anëtarë,
7. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport ,11 anëtarë,
8. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, 11 anëtarë,
9. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, 11 anëtarë,
10. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale,11 anëtarë,
11. Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, 11 anëtarë,
12. Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, 11 anëtarë,
13. Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit,11 anëtarë.

## **b) Propozimi për përbërjen e komisioneve parlamentare**

**Kryetari** i njoftoi anëtarët e Kryesisë se në pajtim me rregullat 41, 42 dhe 48 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit propozon përbërjen dhe strukturën e komisioneve, ndërsa shefat e grupeve parlamentare i nominojnë kryetarët, zëvendëskryetarët dhe anëtarët e komisioneve parlamentare. Ndërkaq, sipas Kreut 9.1.21 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullës 42.4 e Rregullores, kryetarët dhe zëvendëskryetarët e komisioneve caktohen në mënyrë përpjesëtimore ndërmjet partive dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend, përkatësisht në proporcion me forcën e grupit parlamentar.

Mbi këtë bazë **kryetari** paraqiti propozimin për numrin e komisioneve që u takojnë partive apo koalicioneve, si në vijim:

- PDK-ja do t'i kryesojë 3 komisione;
- LDK-ja - 3 komisione;
- AKR-ja - 2 komisione;
- AAK-ja - 2 komisione;
- LDD - 1 komision;
- 7+ dhe të tjerët - 1 komision, dhe
- SLS – 1 komision.

**Nexhat Daci**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit nga Grupi Parlamentar i LDD-së, shtroi çështjen se në përfaqësimin e partive në komisionet parlamentare a llogaritet numri i votave në zgjedhjet e lira dhe numri i deputetëve nga ato zgjedhje, apo merren për bazë kombinatorikat e mëvonshme.

**Sekretaria e Kuvendit** sqaroi se këshilla juridike për Kryetarin është bazuar në rregullat 41, 42 dhe 48 të Rregullores së Punës së Kuvendit, sipas të cilave Kryesia do t'i japë çdo grupi parlamentar, të përfaqësuar në Kuvend, të drejtën që të nominojë kryetarët dhe nënkryetarët e komisioneve të Kuvendit dhe se me këtë rast Kryesia merr parasysht proporcionin e forcës së grupeve parlamentare.

Gjatë debatit mbi këtë çështje, në të cilën morën pjesë të gjithë anëtarët e Kryesisë, u shprehën opinione të ndryshme dhe të diskutueshme lidhur me aplikimin e kriterit për ndarjen e komisioneve në mes të partive politike apo grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvend .

Me qëllim të mënjanim të interpretimeve të ndryshme mbi këtë çështje, Kryesia mori këtë:

## **PËRFUNDIM**

Kryesia e Kuvendit vendosi që nga Zyra e Këshilltarit Ligjor të PSSP-së të kërkohet këshilla juridike lidhur me çështjen, nëse referenca për ndarjen e komisioneve bëhet mbi bazë të përfaqësimit të grupeve

parlamentare apo mbi bazë të partive dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend.

### **3. Të ndryshme**

#### **3.1 Kërkesa e Shtyllës IV për shfrytëzimin e hapësirave me qira në Aneks të ndërtesës së Kuvendit.**

Me propozim të sekretarit të Kuvendit, Kryesia autorizoi të njëjtin që të nënshkruaj kontratën me Shtyllën IV të UNMIK-ut, për vazhdimin e shfrytëzimit të hapësirave me qira në Aneks të ndërtesës së Kuvendit, për aq kohë sa janë deklaruar se UNMIK-u do të qëndrojë në Kosovë.

#### **3.2 Njoftim me kërkesën e Kryesisë drejtuar Ministrisë së Transportit dhe asaj të Drejtësisë për lirim të hapësirave të Kuvendit.**

Pas informimit nga sekretari i Kuvendit lidhur me kërkesën e më hershme të adresuar Ministrisë së Transportit dhe Ministrisë së Drejtësisë për lirim të hapësirave të ndërtesës së Kuvendit, Kryesia ngarkoi Kryetarin e Kuvendit dhe sekretarin e Kuvendit që edhe njëherë ta parashtrijë këtë kërkesë para ministrave të këtyre dy ministrive.

#### **3.3 Akomodimi i grupeve parlamentare**

Kryesia e ngarkoi sekretarin që në bashkëpunim me anëtarët e Kryesisë Xhavit Halitin dhe Eqrem Kryeziun, të bëjnë propozimin për akomodimin e grupeve parlamentare.

#### **3.4 Pajisja e anëtarëve të Kryesisë dhe e stafit politik me aparate telefoni dhe kartela**

Lidhur me këtë çështje Kryesia vendosi që edhe më tutje të vlejnjë rregullat, përkatësisht vendimi aktual për të drejtën e shfrytëzimit të telefonave fiks dhe të lidhjeve Roaming për anëtarët e Kryesisë dhe stafin politik, ndërsa nuk lejohet blerja e aparateve telefonike.

#### **3.5 Angazhimi i Kryesisë për të mbështetur grupet parlamentare**

Me propozim të Kryetarit, Kryesia ngarkoi Xhavit Halitin që të angazhohet për të ndihmuar komunitetin serb dhe komunitetet joserbe për arritjen e marrëveshjes për të pasur përfaqësuesit e tyre në Kryesinë e Kuvendit.

**Kryetari** e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 13:30

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

---

**Jakup KRASNIQI**

E hartoi :

**Divizioni i Çështjeve Plenare e Procedurale**